# DËSHMI ARKIVI

**A-476705**

Factcheck.al · arkiv i pandryshueshëm i mediave shqiptare

VERSIONI 1

> **Ky dokument nuk është prova.** Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

## ARTIKULLI

| | |
|---|---|
| TITULLI | 39-vjeçari vritet dhe bëhet copa-copa në Torino, nëna e autorit: Ishte i tronditur dhe qante shumë |
| ADRESA | `https://top-channel.tv/2026/09/28/39-vjecari-vritet-dhe-behet-copa-copa-ne-torino-nena-e-autorit-ishte-i-tronditur-dhe-qante-shume/` |
| BURIMI | top-channel.tv |
| GJENDJA | online |

## KOHA

| | |
|---|---|
| KAPUR NGA NE | 28 shtator 2026, 14:46:50 UTC<br>*Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.* |
| LEXUAR NGA FAQJA | 28 shtator 2026, 14:42:00 UTC<br>*Portali nuk e deklaron datën në asnjë formë makinë-lexueshme; kjo është ora e shkruar për njeriun, e lexuar nga faqja me metodën **text_date**. Dritarja: 28 shtator 2026, 14:41:00 UTC → 28 shtator 2026, 14:43:00 UTC. Kalon nga një rregull i yni që mund të gabojë, prandaj shfaqet si e lexuar dhe jo si e deklaruar.* |

## HASH-ET · SHA-256

| | |
|---|---|
| PËRMBAJTJA | `c7f8043792327c07cd490dbe3f3fc6dcb0d549a6fbc6a9de97abcc61246178f1` |
| TEKSTI | `69bf826e2a18d20636f31242a6e773ac2adde3ee2cba62be72675a12f6937f91` |
| PAMJA | `5abc3856ec5b103b49c3e97c0e92163c648d8e15f38308ac3084d743fda6eca4` |

## ZINXHIRI I PROVËS

| | |
|---|---|
| KJO HYRJE | `ead58f85a18e9a5537abeede0aadbe274f69b860aa8018c056088a61f8e1b882` |
| E MËPARSHMJA | – |
| RRËNJA MERKLE | `70759019bbbdb922600e92acf251987d45dad965704b935fe53775a49569cfd8` |
| ANKORIMI | submitted — dërguar, ende pa bllok<br>*Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.* |

### SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahaso hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

`https://scan.stamles.eu/verify/ead58f85a18e9a5537abeede0aadbe274f69b860aa8018c056088a61f8e1b882`

## PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

BOTA | TË FUNDIT

# 39-vjeçari vritet dhe bëhet copa-copa në Torino, nëna e autorit: Ishte i tronditur dhe qante shumë

28/09/2026 16:42




**Një 39-vjeçar është vrarë dhe më pas është bërë copa-copa në Torino të Italisë. Për ngjarjen e rëndë ka pranuar autorësinë 26-vjeçari Christian Matheus De Oliveira Morando, i cili dyshohet se e ka vrarë Fabio Colapietro gjatë një konflikti për para.**

Mediat italiane shkruajnë se ngjarja ka ndodhur në një periudhë kur dy personat e përfshirë po konsumonin drogë.

Nëna e 26-vjeçarit ka rrëfyer për emisionin italian "Ore 11" se djali i saj nuk ishte kthyer në shtëpi prej më shumë se një jave. Ajo tregon se ai e telefonoi dhe i foli në mënyrë të pakuptimtë, duke i lënë të kuptonte se kishte ndodhur diçka shumë e rëndë.

*"Kishte më shumë se një javë që nuk vinte në shtëpinë time. Më telefonoi dhe më tha gjëra të paqarta, duke më bërë të kuptoja se kishte ndodhur diçka shumë e rëndë. Në atë moment i sugjerova të telefononte policinë"*, ka treguar gruaja.

Sipas saj, kur i riu telefonoi policinë, ishte i tronditur dhe qante shumë, ndaj ia kaloi telefonin nënës së tij, e cila shërbeu si ndërmjetëse.

*"Ai kishte thënë se i kishte bërë keq dikujt"*, tregon ajo, duke rrëfyer versionin që i biri i kishte treguar për dinamikën e ngjarjes.

Sipas këtij rrëfimi, 26-vjeçari kishte qenë në një festë ku konsumohej drogë. Ai pretendon se ishte në gjumë dhe, pasi u zgjua, pa një burrë që po i merrte disa sende. Për këtë arsye nisi një përleshje me të, ndërsa në konflikt u përfshinë edhe dy persona të tjerë që ndodheshin në banesë, pronarja dhe një tjetër i ftuar.

*"Pastaj menduan se ky person kishte humbur ndjenjat, por në të vërtetë kishte vdekur"*, ka rrëfyer nëna e të dyshuarit.

Ajo ka folur edhe për gjendjen e të birit, duke thënë se ai ka probleme të lidhura me varësinë nga droga dhe çrregullime të personalitetit.

*"Djali im nuk është mirë për shkak të varësisë nga droga dhe çrregullimeve të personalitetit që ka. Por, pavarësisht gjendjes së tij, ai i bënte keq vetëm vetes"*, është shprehur gruaja.

Sipas saj, 26-vjeçari ka pasur edhe së fundmi disa shtrime në spital, në repartet e psikiatrisë, por është larguar prej tyre pasi nuk arrinte të qëndronte aty.

**Top Channel**

## Bota »





## Kryesore



"Taulant Balla jam, më duhen 100 mijë euro", si tentuan dy të rinjtë të mashtronin Armand Dukën, agjenti i infiltruar iu prezantua si djali i kreut të FSHF
13:51

Kuvendi i Kosovës miraton deklaratën për ish-krerët e UÇK-së: Kundërshtojmë aktgjykimin e padrejtë
12:58

"Shtatë kandidatë për BE, sa fëmijët e Ursulës"/ Ironia e Ramës: Von der Leyen nuk u tha vajzave "shko me gangsterin rus" apo "luaj me lodrat kineze"
11:06

Puna e bërë duhet t'i njihet Shqipërisë"/ Zyrtari i lartë i BE, McAllister: Parlamenti Europian do vijojë mbështetjen
12:22

"Kujdes!"/ Autoriteti për Sigurinë Kibernetike ngre alarmin për WhatsApp: Po komprometohen llogaritë në rajon, ja si të mbroheni
10:15

## Më të lexuarat

"Taulant Balla jam, më duhen 100 mijë euro", si tentuan dy të rinjtë të mashtronin Armand Dukën, agjenti i infiltruar iu prezantua si djali i kreut të FSHF

Presidenca zbardh mbledhjen e Këshillit të Sigurisë Kombëtare dhe arkivon Vlora Hysenin: Drejtësia të bëjë punën e vet, çështjet individuale...

Detaje/ Mbyllet mbledhja e Këshillit të Sigurisë Kombëtare pas 90 minutash diskutime, i pranishëm edhe kreu i SPAK

Greqia shkakton 'tërmet' në Gjermani, mposht 4 herë kampionët e botës

11 fëmijë, 7 gra, 3 Champions, 160 milionë të humbura, jeta e shfrenuar e Roberto Carlos

FOTOLAJM/ U shfaq për herë të parë në publik, kush është Elvis Lila, drejtuesi i SHISH i komanduar nga Rama

Sot Konferenca Ndërparlamentare, Rama, Peleshi dhe Schieder të pranishëm. Në fokus zgjerimi i BE dhe integrimi i Shqipërisë

Shkarkimi i Vlora Hysenit, mblidhet Këshilli i Sigurisë Kombëtare i thirrur nga Presidenti Begaj



I akuzuar për krime të lidhura me gjenocidin në Ruandë, 100 mijë paund garanci për të, nëse kushti financiar nuk plotësohet…

28/09 16:40



Irani pas sulmit në bazën angleze, burimi i Reuters: Lidhja me Teheranin, më e mundshmja për pesë të arrestuarit

28/09 16:39



Ndodh për herë të parë në Holandë, Eutanazi ndaj një fëmije 2-vjeçar

28/09 16:35

"Kujdes!"/ Autoriteti për Sigurinë Kibernetike ngre alarmin për WhatsApp: Po komprometohen llogaritë në rajon, ja si të mbroheni

Mesazhe me përmbajtje seksuale me nxënësen 13-vjeçare, arrestohet mësuesi 60-vjeçar në Lushnje



Planifikonin sulm terrorist pranë bazës amerikane në Britani/ Si u arrestuan 5 të dyshuarit, telefonata që ngriti alarmin

28/09 16:26



Video/ Akademia e Shkencave në Kiev përfshihet nga flakët pas një sulmi me dron rus, një i vdekur dhe tre të plagosur

28/09 16:18



Vdekja e George Mazonakis, infermierja "gozhdon" dy mjekët e arrestuar: Të gjithë jemi përgjegjës

28/09 16:13

## Na ndiqni:

Top Channel | @topchannelalbania | @tchbreakingnews | Top Channel

## Video »



Top News-Votimi unanim për Deklaratën e Kuvendit/ Hamza kërkon vullnet politik dhe për ligjin e DhSK



Top Channel/ Në prani të Papës, Macron i kërkon Europës t'i rezistojë nacionalizmit dhe urrejtjes



Top Channel/ Papa Leoni: Guxim për paqen. Europa të mos mbështetet te riarmatimi



Top Channel/ BE-ja përballë sulmeve hibride. Kallas: Protokoll urgjence për reagim të përbashkët



Top Channel/ Irani pas sulmit në bazën angleze.Burimi i Reuters: Lidhja me Teheranin, më e mundshmja



Top Channel/ Kujdes me bisedat në WhatsApp. AKSK: Raste komprometimi në rajon




**© Top Channel 2001 - 2026 • Ndalohet riprodhimi i paautorizuar i përmbajtjes së kësaj faqeje.**


Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.